



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

BE QENDRA E KUVENDIT

BE LAJME qershor 2016
BEQ-numër 22/2016



TAKIM I KËSHILLIT EVROPIAN



Më 28 dhe 29 qershor të këtij viti, 27 shefat e vendeve ose qeverive u takuan të bisedojnë për implikimet politike nga “Brexit”. Liderët ngiten debat në lidhje me të ardhmen e Bashkimit Evropian. Shefat e vendeve dhe qeverive përsëri do të takohen në shtator në Bratisllavë dhe do të vazhdojnë bisedimet.

Në deklaratën e përbashkët pas takimit, liderët e dhanë njoftimin si vijon: “Ne, shefat e vendeve ose qeverive të 28 shteteve - anëtare si dhe kryetarët e Këshillit Evropian të Komisionit Evropian, ndiejmë keqardhje të thellë për epilogun nga referendumi në Britaninë e Madhe, por e respektojmë vullnetin e shprehur nga shumica e britanikëve. Derisa Britania e Madhe të largohet nga BE, e drejta e BE-së vazhdon të zbatohet ndaj dhe nga Britania kur bëhet fjalë për të drejtat dhe obligimet.”

Në takimin e Këshillit Evropian theksi u vu mbi pasojat politike nga referendumi në Britaninë e Madhe. Liderët, gjithashtu diskutuan edhe çështje të tjera, si: Përballja me krizën e emigrantëve, thellimi i tregut të vetëm për zmadhimin e rritjes dhe vendeve të punës, thellimin e sigurisë në BE.

Kryeministri britanik Dejvid Kamerun, e prezantoi situatën në shtet, pas zgjedhjeve, dhe theksoi se vendimi të aktivizohet neni 50 i Marrëveshjes për Bashkimin Evropian do të merret nga udhëheqësit e ri të Britanisë.

Liderët e BE-së vëmendjen e vendosën drejt rutës Qendrore Adriatik, ku qarkullimi i emigrantëve zakonisht ekonomik, ngel në nivel të njëjtë si vitin e kaluar. Ata e theksuan nevojën për partneritet të barabartë për bashkëpunim me vende të caktuara të origjinës ose transit. Liderët përkujtuan se kalimi nga Turqia deri në ishujt greke, tani më pothuajse është ndërprerë. Megjithatë, është me rëndësi të vazhdojë me punë që të stabilizohet situata

dhe të sigurojë zgjidhje të qëndrueshme. Të gjitha aktivitetet dhe strategjitë të cilat vlejné për tregun e vetëm të cilët Komisioni kohë më parë i ka prezantuar, do të implementohen nga viti 2018. Më konkretisht, bëhet thirrje për “progres të shpejtë dhe të përcaktuar” të:

- Iniciativave të cilat kanë për qëllim krijimin e tregut të vetëm të lirë dhe të sigurt digjital.

- Vendosija e pasaportave për shërbime të cilat do ti nxitin bizneset në sferat kryesore që tu ofrojnë shërbimet e tyre në vend tjetër anëtare të BE-së,

- Aktivitete në drejtim të Bashkimit të Tregjeve të Kapitalit, dhe

- Përpjekje për rregullativë më të mirë.

Çdo vit, në qershor Këshilli do të paraqesë raport të liderët e BE-së në lidhje me progresin e arritur për thellimin e tregut të vetëm.

Këshilli i Evropës i theksoi rekomandimet për çdo shtet. Ato formalisht do të miratohen nga Këshilli më 12 korrik 2016 me rastin e shënimit të fundit të ciklit të Semestrit Evropian 2016. Rekomandimet pritet të reflektohen nga vendet anëtare në politikat e tyre nacionale në vitin 2016.

Liderët biseduan për bashkëpunimin ndërmjet BE- së dhe NATO-s në prezencë të sekretarit të NATO-s.

Kryeministri Holandez e prezantoi epilogun nga referendumi për Marrëveshjen për Asociim me Hungarinë dhe Këshilli Evropian kërkoi nga Këshilli të gjejë zgjidhje për zgjedhjen e këtij problemi.

<http://www.consilium.europa.eu>

Përmbajtja e lajmeve:

Mbledhje e Këshillit Evropian	1
Në fokusin e Parlamentit Evropian	2
Referendum për anëtarësim të Britanisë së Madhe në BE	3
Kompanitë Evropiane në pritje të anulimit të sanksioneve kundër	4
Hungaria me rrogë më të mëdha kundër largimit të mjekëve	5
Takimi i 13-të i Komitetit për stabilizim dhe asociim ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe BE-	6
Java Evropiane e eShëndetësisë	6
Ditët Evropiane të zhvillimit 2016	7
Dëshmipërbim për vonesën e fluturimit më tepër se 3 orë	8
Plan për avancimin e shkathtësive digjitale në BE	9
BE kalendar korrik /2016	9

NË FOKUSIN E PARLAMENTIT EVROPIAN

Sesioni plenar 06 qershor 2016

Euro parlamentarët i përshëndetën planet për njoftimin e vendeve për origjinën e emigrantëve, në veçanti në Afrikë, gjatë debatit me komisarin Frans Timmermans dhe shefin për Politikë të Jashtme të BE-së, Federika Mogherini, por Qëllimi është të mbështetet zhvillimi ekonomik dhe social dhe kufizimi i lëvizjes së emigrantëve drejt BE-së.

Euro deputetët debatuan për propozimin për kartonë të gjelbër që do të mundësojë Evropa të tërheqë punëtorë të huaj të kualifikuar.

Gjatë debatit euro deputetët shfaqën ndarje në lidhje me rezultatet nga plani investues i deritanishëm i BE-së. Komisari për vende pune, rritje, investime dhe konkurrencë Jirki Katainen theksoi se planet janë të dobishme për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, dhe propozoi zgjerimin e të njëjtave në vendet jashtë BE-së. Parlamenti Evropian e miratoi raportin me të cilin kërkohet nga Komisioni Evropian të propozojë rregulla për tregti të drejtë ndërmjet bujqve dhe supermarketëve, të cilat duhet të ndihmojnë në parandalimin e hedhurinave nga ushqimi dhe hiper prodhimi.

Është miratuar mandati i Komisionit Anketues për Dokumentet e Panamasë. 65 anëtarë në afat prej 12 muaj duhet të realizojnë kontroll të detajuar të miliona dokumenteve që u lëshuan në prill si dhe ti prezantojnë konstatimet për zbatimin e të drejtës në BE për pastrimin e parave dhe evazion fiskal.

Euro deputetët e aprovuan propozimin e Komisionit Evropian për direktivën për evitimin e evazionit fiskal. Në bazë të parimit se tatimi duhet të paguhet kur do të bëhet profit propozimi përmban masa juridike obliguese për bllokimin e metodave më të zakonshme për kompanitë për evitimin e pagimit të tatimit.

Euro deputetët debatuan si kompanitë evropiane mund të kenë dobi nga programet evropiane për orientimin e hapësirës, siç janë Kopernik dhe Galileo dhe se si satelitët dhe sistemet për navigacion mund të krijojnë mundësi për siguri dhe mbrojtje.

Parlamenti e aprovoi planin për përmirësimin e mobilitetit të punëtorëve në BE nëpërmjet thjeshtësimit të rregullave në lidhje me dokumentet personale dhe publike.

Në rezolutën e miratuar euro deputetët ashpër e kritikuan Komisionin për mos suksesin të sigurojnë kritere shkencore për identifikimin e çrregullimeve endokrine një lloj të kemikateve të cilat janë të dëmshme për sistemin hormonal në trup. Kjo vijoi pasi Gjykata e drejtësisë e BE-së gjykoi se Komisioni ka

shkelur të drejtën e BE-së me prolongimin e vazhdueshëm të masave.

Sesioni plenar 22 qershor 2016

Euro deputetët e theksuan nevojën për intensifikimin plotësues të përpjekjeve për kundërshtimin e radikalizmit në internet, në burgjet dhe shkollat si dhe për parandalimin e përhapjes së urrejtjes. Në debat u theksuan progresi i arritur në këtë sferë nëpërmjet formimit të Seksionit për Dërgim nëpërmjet Internetit të Evropës. Disa euro deputetë e kritikuan Komisionin Evropian të BE-së se nuk bën mjaftueshëm për rreptësi të kontroleve kufitare dhe bënë thirrje për sanksione më të rrepta kundër udhëtimeve për shkak të terrorizmit ose kremitimi të akteve terroriste.

Me dy rregulla, një për regjimin martesor për pronësi dhe tjetri për pasojat mbi pronën e partneritete të regjistruara, përcaktohet cila gjykatë ka kompetencë dhe cili ligj zbatohet gjatë procedurave të cilat vlejnë për pronën e çifteve ndërkombëtare. Ato, gjithashtu do ta lehtësojnë njohjen dhe kryerjen e akt gjykimin të miratuar në një vend anëtarë të çështjes pronësore në vend tjetër anëtar.

Euro deputetët e aprovuan propozimin për ndarjen e ndihmës për Belgjikën në shume prej 1.824.041 euro për gjetjen e vendeve të reja të punës për 488 punëtorë të shpallur si tepriç teknologjike nga prodhuesit e makinave ndërtimore në Valoni. Ehe 300 persona të rinj të papunësuar, gjithashtu, duhet të përfitojnë nga ndihma e cila vjen nga Fondi Evropian për përshtatje me globalizimin.

Parlamenti Evropian i bëri thirrje BE-së të investojë më tepër në informata dhe mbështetje të programeve në vendet anëtare të cilat mund të ndihmojnë të rritet pjesëmarrja në programet lokale rrjedhëse për efikasitet energjik.

Sesioni plenar 28.006.2016

Gjatë hapjes së seancës së jashtëzakonshme, kryetari i Parlamentit Evropian Martin Shulc theksoi se për herë të parë në historinë e seancave plenare konvokohet seancë për kohë kaq të shkurtë. Ai e përshëndeti Lord Hil dhe i faleminderit për punën e tij në Komisionin e BE-së. Ai udhëhoqi me fushatën për Britaninë e Madhe që të qëndrojë në BE. Deklarata e tij u përçoll me ovacione edhe nga Parlamenti Evropian edhe nga Komisioni.

<http://www.europarl.europa.eu/portal/en>

REFERENDUM PËR ANËTARËSIM TË BRITANISË SË MADHE NË BASHKIMIN EVROPIAN

Shumica e britanikëve në referendumin e mbajtur më 23 qershor të këtij viti u deklaruan për daljen e Britanisë së Madhe nga BE.

Sipas rezultateve nga votat e numëruara në të gjitha vendet e votimit 17.410.742 votues ose 51,9% janë deklaruar për dalje nga Britania e Madhe nga BE-ja, ndërsa 16.151.241 ose 48,1% kanë votuar që shteti të ngelet në Bashkimin Evropian, deklaroi Bi- Bi- Si.

Dalja në referendum ka qenë 71,8% që paraqet daljen më të lartë në votime në Britaninë e Madhe nga zgjedhjet parlamentare të vitit 1992.

Pas shokut fillestar, udhëheqësit e BE-së, Zhan Klod Junker, Donald Tusk, Martin Shulc dhe të tjerët dërguan mesazh të qartë se edhe përpos asaj që ndjejnë keqardhje për këtë vendim, se e njëjta është realitet dhe prandaj tani Brukselit i nevojitet dalje më e shpejtë e britanikëve me qëllim stabilizimin e tregut financiar.

Tani fillimisht britanikët duhet të aktivizojnë nenin 50 të Marrëveshjes së Lisbonës dhe me këtë notifikim të fillojë të rrjedhë afati kohor prej dy vjet për daljen përfundimtare dhe zyrtare të Britanisë së Madhe nga Bashkimi Evropian. Por, për shkak të dorëheqjes së kryeministrit Kameron, është e mundshme britanikët të prolongojnë aktivizimin e këtij neni dhe me këtë edhe daljen e tyre zyrtare nga Unioni, por edhe nga takimet e Këshillit Evropian, do të mund të zgjasë deri në pafund.

Nëse nuk merret vesh më ndryshe me Britania e Madhe në nivel të BE-së vend i tretë, është e mundur të gjitha BE institucionet dhe agjencitë në Britani të tërhiqen, edhe pse tregu financiar është gjëja e parë që do të diskutohet në suazat

e negociatave për daljen e britanikëve. Bashkimi Evropian prej Britania sa më shpejtë të paraqesë aktivizimin zyrtar të nenit 50 të marrëveshjes, që të fillojnë negociatat dhe tregu të mos e ndjejë aq fuqishëm daljen e Mbretërisë së Bashkuar nga Bashki Evropian.

Nga Brukseli konfirmohet se tani për tani ngel vendimi i Këshillit të Evropës për Britaninë e Madhe që të kryesojë me Këshillin e Evropës nga qershori i vitit të ardhshëm nëse deri atëherë ky shtet akoma është anëtar e BE-së. Gjithashtu, gjuha angleze do të ngelë si një nga 24 gjuhët zyrtare që fliten në BE edhe pas daljes së Britanisë së Madhe dhe kjo për shkak se gjuha e njëjtë është gjuhë e dytë zyrtare në Irlandë, vend anëtar i Unionit. Por, nga ajo që mund të vërehet është shqetësimi te mbi 1000 punëtorë britanikë në institucionet e BE-së të cilët po aplikojnë në mënyrë masive të fitojnë shtetësinë e ndonjërit nga 27 vendet e tjera anëtare të Unionit, më së shumti të vendit nikoqir Belgjikës, me qëllim ti mbajnë vendet e tyre të punës.

Pas referendumit është ngritur peticion me të cilin bëhet thirrje për ri shqyrtimin e rezultateve nga referendumi për anëtarësim të Britanisë së Madhe në Bashkimin Evropian e cila duhet të shqyrtohet në mbledhjen e komitetit parlamentar. Që të shqyrtohet peticioni Parlamenti Britanik duhet të ketë të paktën 100 mijë nënshkrime.



<http://www.independent.co.uk/topic/brexit>

KOMPANITË NË EVROPË PRESIN ANULIMIN E SANKSIONEVE KUNDËR RUSISË



Senati francez më 9 qershor të këtij viti më shumicë votash miratoi rezolutën e cila edhe pse nuk është obliguese kërkohet nga qeveria të abrogojë sanksionet ekonomike kundër Rusisë. Sipas shumicës në Be, sanksionet nuk i dhanë efektet e dëshiruara, ndërsa persona zyrtarë tregojnë se parakusht për largimin e tyre është zbatimi i plotë i marrëveshjes paqësore të Minsk për Ukrainën. Kompanitë evropiane pësojnë pasoja nga sanksionet, pamundësi për eksport në Rusi dhe janë të shqetësuar për humbjen e vendit të tyre në treg. Njëkohësisht, Rusia, si përgjigje ndaj sanksioneve evropiane vendosi ndalim për import të ushqimit nga BE-ja. Edhe pse vuan dëme të mëdha por jo me përmasa të mëdha, prodhimi bujqësor në Rusi po rritet dukshëm.

Edhe përkaj kundërshtimit të qeverisë franceze të socialistëve, pas debatit që zgjati disa orë, për rezolutën e "abrogimit gradual dhe të pjesshëm" të sanksioneve kundër Rusisë më 8 qershor votuan 302 anëtarë të Dhomës së Lartë të Parlamentit Francez, ndërsa 16 kanë qenë kundër.

Bashkimi Evropian me vite është partneri më i madh tregtar i Rusisë, por para dy vjet vendosi sanksione për shkak të Ukrainës. Sanksionet janë në lidhje me baza të ndryshme, nga ndalimi i eksportit të pajisjes për ekstraktim të naftës në Rusi deri te refuzimi i qasjes për kreditim afatgjatë në bankat ruse. Si përgjigje për këtë Moska e ndali importin e zarzavateve, produkteve të qumështit dhe mishit nga BE-ja. Importi i BE-së nga Rusia është ulur për 1/3 në 2015. Për dallim nga 2013 para vendosjes së sanksioneve. Eksporti i produkteve bujqësore nga BE për Rusinë është gjysmuar në raport me periudhën e njëjtë.

Kompanitë franceze për automobil, naftë dhe kompanitë ushqimore kanë pasoja të mëdha nga sanksioneve e Rusisë dhe prej embargos kthyesë Ruse dhe prandaj "qetë" llojnë të politikanët francez për abrogimin e sanksioneve.

Gjithashtu deputetët në kuvendin Francez kryesisht nga partia konservatore Republikanët ankohen se sanksionet i shkaktojnë dëm ekonomisë franceze dhe theksojnë se Franca dhe Evropa nuk duhet të ndjekin politikën Amerikane ndaj Rusisë.

Në mesin e shteteve kompanitë e të cilave janë

të shqetësuar për efektin e luftës tregtare me Rusinë është edhe Gjermania partneri tregtar më i madh i Rusisë para vendosjes së sanksioneve. Kompanitë gjermane janë të shqetësuar se vështirë do të kthejnë reputacionin në tregun rus nëse zgjasin sanksionet, thekson Matijas Placek, drejtor i forumit gjerman - rus - lobi grupi i cili përfaqëson interesat e Gjermanisë dhe Rusisë.

Kompanitë gjermane në fillim nuk i kanë kundërshtuar sanksionet, por me kalimin e kohës prodhuesit e qumështit po reagojnë për sasinë e madhe të cilën nuk kanë mundur ta eksportojnë në Rusi. Kjo ka rezultuar me rënien e çmimit nën nivelin e shpenzimeve për prodhim. Qeveria u ka premtuar prodhuesve të qumështit se do të sigurojë të paktën 100 mijë euro ndihmë dhe se do të negociojë në Bruksel për gjetjen e zgjidhjes për problemin.

Sanksionet kundër Rusisë janë vendosur për shkak të aneksionit të Krim dhe për shkak se u zgjeruan kur Moska i mbështeti rebelët separatist në pjesën lindore të Ukrainës.

Në ndërkohë bujqësia në Rusi është një nga sektorët i cili shënon rritje të pjesshme dhe si rezultat i ndalimit të importit të ushqimit nga BE. Prodhimi rus i djathit në 2015 është rritur për 18% ndërsa e perimeve 13%.

Duke ju përgjigjur shqetësimit të bujqve të cilët janë të shqetësuar nga kohërat e vështira kur në treg do të kthehen prodhuesit nga BE, kryeministri Dimitrij Medvedev në maj kërkoi nga qeveria të vazhdojë ndalimi për import të ushqimit deri në fund të vitit 2017.

<http://bigstory.ap.org/article>

HUNGARIA ME RROGA MË TË LARTA KUNDËR LARGIMIT TË MJEKËVE

Qeveria në Hungari më 9 qershor njoftoi se pagat do të rriten ndjeshëm në sektorin e shëndetësisë, pasi vendi përballet me një rrjedhje masive të mjekëve dhe punonjësve të shëndetësisë jashtë vendit.

Mjekët dhe farmacistët mesatarisht do të marrin paga 20% më të larta, si dhe punëtorët e tjerë shëndetësorë ngritje prej 100 euro, me tendencë që të dyfishohen deri në vitin 2019. Programi për rritjen e pagave në shëndetësi është miratuar në marrëveshje me sindikatat dhe kjo do t'i kushtojë Hungarisë rreth 320 milionë euro për periudhë prej dy vjetësh. Financimi i programit është paraparë në buxhetin.

Në mes të majit, rreth 5,000 infermiere dhe punëtorë të tjerë shëndetësorë organizuan demonstrata në qendër të Budapestit me kërkesa për kushte më të mira pune dhe paga më të larta.

Rritja e pagave të mjekëve dhe farmacistëve, në varësi të specializimit dhe viteve të stazhit do të jetë midis 50,000 dhe 107,000 forinta bruto, d.m.th. nga 160 deri në 345 euro.

Ministri i Shëndetësisë së Hungarisë Zoltan Balog theksoi se është planifikuar rritje në vitin 2017, me çka rritja e përgjithshme e pagave do të jetë 40%. Punëtorët e tjerë shëndetësorë në vjeshtë do të marrin një rritje prej 30.000 forinta ose 100 euro, që është për 25% më shumë se paga aktuale. Pagat e tyre do të duhet të dyfishohet nga viti 2019, theksoi ministri. Paga minimale në shëndetësi në Hungari është 340 euro.

Hungaria përballet me një rrjedhje masive të mjekëve dhe infermierëve në vendet e pasura të BE-së. Shumica e mjekëve në Hungari punojnë në sektorin publik dhe pagat e tyre në vitet e fundit janë ngritur vetëm në mënyrë simbolike.


Presidenti i shoqatës mjekësore Ishtvan Eger vuri në dukje se marrëveshja me qeverinë është rezultat i negociatave "negociatave shumë të gjata" dhe se përfundimisht të gjithë mund të jenë të kënaqur me rezultatin.

Në Evropën Perëndimore punojnë më shumë se një mijë mjekë dhe infermierë hungarezë të cilët në ato vende mund t'i shumëfishojnë të ardhurat për 4-5 vjet.

Vetëm në Mbretërinë e Bashkuar punojnë 1,800 mjekë dhe një numër dukshëm më i madh i infermierëve nga Hungaria.

Rreth 500 miliarda franga hungareze janë shpenzuar në zhvillimin e infrastrukturës për kujdesin shëndetësor në vendin gjatë katër viteve të fundit. Një shtesë 100 miliardë franga hungareze do të shpenzohen për rritjen e pagave këtë vit dhe në vitin e ardhshëm 2017.

Në pres-konferencën për shtyp, kryetari i Sindikatës Demokratike Sociale e punëtorëve shëndetësorë Agnes Zer, i cili ishte krye negociatori në negociatat



TAKIMI I 13-TË I KOMITETIT PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM NDËRMJET REPUBLIKËS SË MAQEDONISË DHE BE –SË



Komiteti për Stabilizim dhe Asociim ndërmjet Maqedonisë dhe BE-së u mbajt më 15 qershor 2016.

Me takimin kryesonte Anna Blazheska, Sekretarja shtetërore e Sekretariatit për Çështje Evropiane dhe Dejvid Kullen kryesuesi i Njësisë për Maqedoninë në Drejtoria për Zgjerim dhe Politikë të Fqinjësisë.

Takimi i Komitetit për Stabilizim Asociim përfundoi ciklin e shtatë nën-komiteve sektoriale në kuadër të Procesit të Stabilizim Asociimit duke filluar prej shkurt 2016.

Rezultatet e takimit të Komitetit do të prezantohen në kuadër të Këshillit për Stabilizim -Asociim, i cili do të zhvillohet në korrik 2016.

Komiteti për Stabilizim-Asociim diskutoi në lidhje me shkallën e përmbushjes së kriterëve politike

dhe ekonomike në periudhën e kaluar, si dhe nivelin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Përfaqësuesit e Republikës së Maqedonisë e konfirmuan angazhimin për procesin e integritit evropian si një prioritet kyç strategjik i vendit dhe u angazhuan të tregojnë progres të dukshëm në zbatimin e detyrimeve të agjendës së BE-së në fushat e Prioriteteve për reforma urgjente.

www.sep.gov.mk

ЕВРОПСКА НЕДЕЛА НА Е-ЗДРАВСТВО



Nga 8 deri më 10 qershor në Amsterdam, Holandë u mbajt java e e-shëndetësisë. Ngjarja u shënuar me shumë ngjarje të ndjekura nga rreth 2.230 vizitorë nga më shumë se 55 shtete të botës dhe nga 6 kontinente. Morën pjesë rreth 54 ekspozues dhe më shumë se 130 folës.

Drejtori i Përgjithshëm i rrjetit global të informacionit shëndetësor dhe sistemet e menaxhimit social, HIMSS, Stiven Liber ndau çmimin vjetor për udhëheqje në e-shëndetësi Daniel Forslundit, komisionerit për risi dhe e-shëndetësi në Këshillin Nacional të Stokholmit.

Ane-Mieke Vrum, drejtor i Fondacionit IKONE i cili vuan nga një sëmundje e rrallë e indit lidhës qysh prej fëmijërisë, i quajti pacientët motorët e progresit dhe inovatorë dinjitoz.

Në fokus të seancave dhe i pjesës më të madhe të Javës Evropiane të e-shëndetësisë ishin aplikacionet e fuqishme IT për pacientët dhe mjekët.

Nëse një ose më shumë prej fituesve të javës së këtij viti të e-shëndetësisë do të bëhen lojtarë të mëdhenj global, mbetet

për t'u parë. Fitues në kategorinë "Kompanitë që premtojnë", me një qarkullim vjetor prej më pak se gjysmë milion euro është Symptoma me seli në Austri për Kërkues diagnoze për mjekët.

Në kategorinë "kampionë" të kompanive më të mëdha me seli në Paris, "iHealth" e mori udhëheqsinë, me platformën e menaxhimit të largët për sëmundjet kronike.

Pothuajse nuk do të ekzistonte konferenca për e-shëndetësi pa u hapur debati për aplikimet për rregullimin.

Komisioni Evropian paraqiti versionin përfundimtar të kodit privat për aplikimet mHealth dhe gjithashtu e bëri të qartë se nuk planifikon të ndalet aty. Për momentin përkufizohet baza për vlerësim të vlefshmërisë dhe besueshmërisë së mHealth aplikacioneve. Kjo do të vlejë kryesisht me aplikime-shëndetësore të cilat nuk konsiderohen si pajisje ndihmëse mjekësore dhe do të publikohet në fillim të vitit 2017.

DITËT EVROPIANE TË ZHVILLIMIT 2016

E organizuar nga ana e Komisionit Evropian, ngjarja Ditët e Evropës për Zhvillim 2016 e bashkon unionin zhvillimor çdo vit me qëllim të shkëmbimit të ideve dhe përvojave në mënyrë që të inspirojnë partneritete të reja dhe zgjidhje inovative për sfidat më të mëdha në botë.

Edicioni i dhjetë i Ditëve Evropiane të Zhvillimit 2016 u mbajt në Bruksel më 15 dhe 16 qershor. Me rastin e përvjetorit të dhjetë, ngjarja u përqendrua në "Agjenda 2030 për zhvillim të qëndrueshëm", që e bën atë një nga konferencat e para të mëdha për këtë çështje.

Këtë vit, Ditët Evropiane të Zhvillimit nëpërmjet financimit të projekteve të veçanta do të kontribuojë në reduktimin e emetimeve të CO₂-së deri në 7390 ton metrik.

Ditët Evropiane të Zhvillimit 2016 i prezantuan projektet nën kuadër të "5PS": tema për njerëzit, planetin, prosperitet, paqe dhe partneritetit dhe të sigurojë ilustrime konkrete të politikave aktuale të zhvillimit.

Me ndodhinë u nxit ndërveprimi, risitë, rrjetëzimi mes vizitorëve dhe pjesëmarrësve në promovimin e projekteve të tyre lokale dhe historive të suksesit. Vizitorët patën mundësi të eksplorojnë projekte në 15 nën-tema brenda "5PS" dhe të bisedojnë me ata që

janë përgjegjës për zbatimin e tyre.

Pesë temat ishin të koduara me ngjyra ashtu që vizitorët të mund ta gjenin lehtësisht lëndën e tyre të interesit. Përveç sporteleve u mbajtën mbi 120 seanca lidhur me secilën prej temave, ku vizitorët mundeshin të kyçen në debate mbi temat e kyçe.

Prej mbi 300 kandidatëve u zgjodhën 16 mendjet më të ndritura të të rinjve në zhvillimin ndërkombëtar, të cilët përfaqësuan zërin e të rinjve dhe zhvillimin e ardhshëm të Ditëve Evropiane të Zhvillimit. Programi për Liderët e rinj të Komisionit Evropian i mundëson të rinjtë nga 21 deri në 26 vjet duke marrë parasysh dallimet në vendet dhe komunitetet e tyre, të dëgjohet zëri i tyre në skenën botërore.

Gjashtëmbëdhjetë kandidatët që vijnë nga mjedise të ndryshme dhe vende të forumit prezantuan tema të ndryshme që lidhen me qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Çdo lider i ri mori pjesë në trajnimin e parashikuar nga Qendra e Përbashkët Kërkimore dhe mbajtën



DËMSHPËRBLIM PËR VONESËN E FLUTURIMIT PËR MË TEPËR SE TRI ORË



Derisa miliona evropianë përgatiten për të udhëtuar gjatë pushimeve të ardhshme verore, Komisioni Evropian ju përkushtua dhe të drejtave të pasagjerëve të komunikacionit ajror në BE.

Komisioni Evropian më 10 qershor të këtij viti miratoi udhëzime të reja për t'i sqaruar rregullat ekzistuese dhe për lehtësimin e zbatimit të tyre në dobi të udhëtarëve dhe bizneseve. Për nevojën për sqarimin e rregullave evropiane për të drejtat e pasagjerëve të trafikut ajror tregon edhe numri i madh i aktgjykimeve në Gjykatën e Drejtësisë në ankesat e dorëzuara nga udhëtarët pakënaqur.

Udhëzimet e miratuara janë pjesë e Strategjisë për aviacionin evropian nga ana e Komisionit në dhjetor 2015 me qëllim që ta forcojë konkurrencën dhe t'i ruajë standardet më të larta të Aviacionit Evropian.

Bashkimi Evropian është i angazhuar që t'i mbrojë të drejtat e pasagjerëve në të gjitha llojet e transportit. "Të gjithë qytetarët e BE-së që udhëtojnë me aeroplan duhet ta marrin mbrojtjen që e meritojnë," tha komisionari për transporti evropian Violeta Bul.

Ligji i BE-së për të drejtat e pasagjerëve të komunikacionit ajror është ndër më të përparuarit në botë dhe ofron një shkallë të lartë të mbrojtjes kundër rrethanave të

paparashikuara për njerëzit që udhëtojnë me aeroplan në BE dhe prej BE-së. Megjithatë, siç njoftoi Komisioni Evropian, një numër i aktgjykimeve të Gjykatës së Drejtësisë të BE-së kanë të bëjnë me përmbajtjen dhe shtrirjen e ligjit i cili hyri në fuqi në vitin 2005.

Kur bëhet fjalë për kompensim të dëmit, udhëzimet e miratuara parashikojnë që udhëtari të ketë të drejtë për kompensim në rast të vonesës së fluturimit për tre orë deri në destinacionin përfundimtar. Gjithashtu, udhëtari ka të drejtë për kompensim në qoftë se ai nuk arrin të lidhet me një fluturim tjetër për destinacionin e fundit, për shkak të prolongimit të gjatë dhe pritjes për arritjen.

Aero-kompanitë duhet të fokusohet në sigurimin e udhëtimit të shpejtë dhe efikas. Ato janë të detyruara t'i informojnë pasagjerët për vonesat dhe t'i japin shpjegim brenda 30 minutave pas skadimit të kohës së caktuar për hipje në aeroplan. Theksohet se në situata të jashtëzakonshme, siç janë mungesa teknike aero-kompanitë nuk mund të lirohen nga pagesa e kompensimit të dëmit në rast të anulimit ose vonesës së fluturimeve. Në situata të tilla, udhëtari ka të drejtë për ndihmë dhe përkujdesje për kohëzgjatjen e gjendjes së jashtëzakonshme, si në gjendjen e jashtëzakonshme e cila është shkaktuar nga retë me hi për shkak të

PLAN PËR AVANCIMIN E SHKATHTËSIVE DIGJITALE NË BE

Për momentin, në shumicën e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, 2/5 e popullsisë së përgjithshme është e përjashtuar nga përparësitë e shoqërisë informatike.

Në Maqedoni kjo shifër arrin prej 50% deri në 70%.

Sipas disa hulumtimeve të caktuara, vetëm 50% e popullsisë përdor kompjuter dhe vetëm 30% përdorin internet. Këtë përqindje të personave e quajnë edhe analfabetë digjital, me pasoja potenciale të rënda për punësim dhe integrimin shoqëror.

Sipas vlerësimeve të sektorit të teknologjisë evropiane, deri në vitin 2020 do të ketë 756,000 vende pune të paplotësuara në sektorët e teknologjisë dhe shëndetësisë si sektorë të cilët kompanitë kanë probleme për të siguruar punëtorë adekuatë të trajnuar profesionalisht.

Në BE, më së shumti analfabetë digjital ka në Rumani, ku 74% e fuqisë punëtore nuk kanë njohuri të duhur për përdorimin e teknologjive të reja, ndërsa fuqia punëtore më e arsimuar digjitale është në

Luksemburg.

Komisioni Evropian i bëri thirrje qeverive nacionale të dalin me plane strategjike për ta rritur shkallën e arsimit teknologjik. Sipas të dhënave të Komisionit, 41% e fuqisë punëtore në BE ka pak ose aspak aftësi digjitale.

Komisioni njoftoi se këtë vit do të ngrejë një koalicion që ta bashkojë nismën për t'i avancuar aftësitë digjitale.

Ndërkohë ekspertët parashikojnë se BE-ja do të fitojë 28,000 vende të reja pune duke ju falënderuar rregullores së miratuar kohët e fundit për mbrojtjen e të dhënave.

Komisioni njoftoi se ka ndërmend ta lehtësojë mënyrën për të fituar punë në Evropë për shtetasit e vendeve jashtë BE-së përmes një viza skeme për punëtorët e kualifikuar "karta blu".

Komisari Evropian për Emigrim, Punë e Brendshme dhe Shtetësi, Dimitris Avramopoulos, shpjegoi se programi i ri duhet t'i konkurrojë "kartës së gjelbër"



BE KALENDAR / korrik 2016

1. Presidenca Sllovaqe e Këshillit të BE-së;
2. Seanca plenare e Parlamentit Evropian, 04/08 / 07/2016, Strasburg;
3. Samiti i shtatë evropian i regjioneve dhe qyteteve, 8-9 /07/2016, Bratislavë, Sllovakia.

European Union Newsroom

Search

Home Highlights Press releases Calendar Audiovisual Press contacts Press facilities About the EU

CALENDAR

BROWSE FORTHCOMING EVENTS

By topic
Choose a topic

By organiser
Choose an organiser

By type
Choose a type

BY MONTH

July

Sun	Mon	Tue	Wed	Thu	Fri	Sat
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30
31						



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

BE QENDRA E KUVENDIT

Adresa 11 Tetor nr. 10, Shkup 1000

Telefon: +389 2 3 11 22 33 lokal 414 dhe 289

Faks: +389 2 3 182 277

E-mail: nsei@sobranie.mk

Zyra 019

Sektori për Mbështetje të Këshillit nacional për
Eurointegritime

www.sobranie.mk

Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë gjatë periudhës janar 2011 qershor 2012 u realizua projekti IPA për “Ndihmë teknike për Parlamentin” qëllimi kryesor i të cilit ishte përforcimi i kapacitetit institucional të Kuvendit dhe me këtë përmirësimin e transparencës dhe përgjegjësisë të tij para qytetarëve.

Në kuadër të IPA projektit, u siguroa ndihmë financiare dhe profesionale për vendosjen e BE qendrës në Kuvend.

Qëllimi i formimit të BE qendrës është që deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe Shërbimit të Kuvendit tu sigurojë qasje më të mirë